


BIBLIOTEKA
SHTETIT

577
M 59

LUAN MEMUSHI

Si lindi jeta në TOKE



57
7159

LUAN MEMUSHI

SI LINDI JETA NE TOKE?



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Tirazhi: 5000 kopje Formati: 70 x 100/32 Stash. 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1977

PARATHËNIE

Problemi i origjinës së jetës është bërë sot një nga frontet kryesore të ndeshjes së mendimit materialist me atë idealist në biologji, një nga shfaqjet e luftës klasore në këtë fushë. Konfuzioni ideologjik, që nxitet në vendet kapitaliste dhe revizioniste lidhur me interpretimin e fakteve të zbuluara nga shkencat e sotme, lejon edhe sot në këto vende zhvillimin dhe përhapjen e teorive idealiste mbi origjinën e jetës.

Interpretimi materialist dialektik i teorive dhe i zbulimeve të mëdha të shekullit tonë rreth këtij problemi, ka rëndësi të madhe në luftën tonë kundër ideologjisë së huaj borgjezo-revizioniste. Kjo luftë duhet zhvilluar, sikurse na mëson shoku Enver, në të gjitha fushat.

Problemi i origjinës së jetës ka rëndësi të madhe filozofike sepse bazën shkencore të botëkuptimit të njerëzve e përbëjnë edhe pikëpamjet e tyre mbi natyrën e gjallë, origjinën dhe zhvillimin e saj. Shoku Enver thekson se «me zhvillimin dhe përparimin e shkencave ne sqarojmë materializmin dhe dialektikën»¹.

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968» faqe 359.

Trajtimi shkencor i problemit të origjinës së jetës në Tokë na ndihmon të forcojmë luftën kundër pikëpamjeve idealiste dhe fetare dhe të formojmë botëkuptimin shkencor materialist. «Vetëm njohja e vërtetë e forcave të natyrës, — thekson F. Engelsi, — dëbon perënditë nga njëra fushë pas tjetrës»¹.

Materiali i shumtë shkencor që është grumbulluar këto kohët e fundit në biologji ka vërtetuar edhe një herë drejtësinë dhe vlerën e madhe të përiemve të materializmit dialektik për njohjen e drejtë dhe për një të kuptuar të thellë të thelbit dhe të origjinës së jetës. Nga ana tjetër zbatimi i metodës dialektike materialiste në kërkimet teorike dhe eksperimentale ka krijuar mundësi të mëdha dhe kushte shumë të frytshme për të zbuluar me saktësi rrugët nëpërmjet të cilave ka kaluar zhvillimi i materies jo të gjallë në atë të gjallë, vendin e jetës në procesin e zhvillimit të materies, marrëdhëniet e jetës me format e ulëta të lëvizjes së materies si dhe ka zbuluar forcat lëvizëse të zhvillimit të natyrës.

Përgjithësimi i kërkimeve biologjike ka jo vetëm një rëndësi teorike, por edhe rëndësi të madhe praktike për njeriun në gjithë ato fusha të veprimtarisë ku ai ka të bëjë me objekte të gjalla.

Në ditët tona një zhvillim të madh ka marrë studimi i sintezës abiotike të lëndëve organike. Njohja e rrugës së sintezës artificiale të tyre, dhe veçanërisht të proteinave, i jep njeriut mjete të reja të fuqishme të drejtimit të natyrës së gjallë si dhe e ndih-

1) Frederik Engels. «Anti-During», Tiranë, 1974, faqe 397-398.

mon atë të gjejë rrugë të reja në drejtim të rritjes së prodhimit të bimëve dhe të kafshëve.

Në këtë broshurë bëhet përpjekje për të shpjeguar nga pozitat e materializmit dialektik problemet që kanë të bëjnë me origjinën dhe zhvillimin e jetës në Tokë. *Shtjellimi i materialit është bërë në mënyrë të tillë që të kuptohet nga një rreth i gjerë lexuesish.*

REDAKSIA

PIKËPAMJET MBI PREJARDHJEN E JETËS GJATË SHEKUJVE

Filozofët e lashtë materialistë zgjidhjen e problemit të lindjes së jetës e lidhnin ngushtë edhe me zgjidhjen e problemit mbi burimin e parë material të Tokës. Që në atë kohë ata shfaqën bindjen se bota është materiale prej natyre, se ajo nuk ka qenë krijuar ndonjëherë dhe do të ekzistojë përjetë, vetëm se do të pësojë këto ose ato ndryshime në saje të ligjeve objektive që e karakterizojnë.

Themeluesi i shkollës së materializmit spontan të Miletit, Talesi (rreth 624-547 para erës sonë), në kundërshtim me pikëpamjet fetare, u mundua të shpjegonte lindjen e jetës duke u nisur nga ideja se materia është primare.

Duke e quajtur ujin elementin ndërtues të të gjithë substancave, ai arriti në përfundimin se dhe organizmat e parë lindën nga uji.

Anaksimandri nga Mileti (rreth 585-525 para erës sonë) thoshte se, nën veprimin e rrezeve të diellit, në ujë, u shfaqën së pari organizmat e ngjashme me peshqit dhe pastaj, prej tyre, kafshët etj.

Herakliti (rreth 540-480 para erës sonë), filozofi i shquar i Greqisë së vjetër, shfaqti idenë mbi unitetin e gjithësisë dhe ndryshueshmërinë si të lëndëve pa jetë, ashtu dhe të lëndës së gjallë. Ai shprehu pikëpamjen se materia është gjithmonë

në lëvizje. Simbas tij, kozmosi është në zhvillim, në lëvizje dhe në ndryshim të përhershëm. Si lëndë të parë ai konsideronte zjarrin. Të gjitha elementet e tjera, sipas tij, nuk janë gjë tjetër vetëm se transformimi i zjarrit. Ky, duke u shuar, shndërrohet gradualisht në ajër, ujë dhe tokë, thoshte Herakliti.

Përfaqësuesit e materializmit atomistik të lashtësisë si Leukipi, Demokriti, Epikuri dhe Lukreci mendonin, sikurse edhe miletasit, se mundësia e lindjes së vetvetishme të organizmave nga trupat e natyrës jo të gjallë ndodh pa asnjë ndikim të forcave mistiko-fetare.

Filozofi materialist i Greqisë së lashtë Empedokli (rreth 485-425 para erës së re) thoshte se organizmat e parë (bimët) lindin edhe në argjil nën ndikimin e nxehtësisë së brendshme të Tokës. Pastaj mendonte ai, krahas bimëve, u shfaqën në Tokë edhe pjesë të kafshëve si p.sh. koka, këmbët, duart etj dhe si rezultat i bashkimit të tyre lindën pastaj organizmat e parë të gjallë shtazorë. Në këto pikëpamje tepër naive të Empedoklit shihet prirja për të shpjeguar formimin e organizmave nëpërmjet seleksionit natyror.

Ideja e prejardhjes natyrore të së gjallës, ishte në atë kohë një ide materialiste, që i kundërvihet idesë fetaro-idealiste mbi lindjen e vetvetishme të jetës në saje të forcave të mbinatyreshme. Kundër këtyre pikëpamjeve përparimtare u hodhën në luftë forcat e reaksionit të Greqisë së lashtë. Përfaqësuesi kryesor i këtyre forcave ka qënë Platoni (rreth 428-348 para erës së re) filozof idealist i Greqisë së lashtë, ideolog i aristokracisë skllavopronare, themelues i idealizmit objektiv.

Ai pranonte aktin «krijues» dhe ekzistencën e

shpirtit të pavdekshëm, «psikikës», e cila gjoja futet në natyrë dhe e ngjall atë.

Teoritë idealiste të Platonit mbi shpirtin e pavdekshëm, «psikikën», ndikuan edhe të Aristoteli, i cili për problemin e lindjes së vetvetishme të jetës qëndron më afër idealistëve sesa materialistëve. Sipas tij, materia pa jetë organizohet tërësisht nën veprimin e fillesave aktive jomateriale.

Të nisur nga autoriteti i madh që gëzonte Aristoteli dhe nga fakti se idetë e tij për prejardhjen e jetës kishin karakter idealist, ato u përhapën shumë në mesjetë. Në këtë kohë u varrosën të gjitha anët pozitive të veprave të Aristotelit dhe u vunë në dukje anët më të dobëta e negative të tyre.

Çdo mendim materialist dhe përparimtar që shprehej në mesjetë nga shkencëtarët dhe mendimtarët goditej pa mëshirë nga ana e fesë. Kisha katolike gjatë kësaj periudhe, në luftën e saj kundër mendimit përparimtar, vuri në veprim inkuizicionin, nga i cili gjetën vdekjen, u masakruan dhe u torturuan me qindra mijëra njerëz përparimtarë, ndër të cilët edhe shkencëtarë të njohur si Xhordano Bruno, Lucilo Vanini, Miguële Serveto etj. Por, pikëpamjet e shkencëtarëve triumfuan mbi pikëpamjet e fesë. Feja u detyrua të tërhiqet para shkencës, e megjithatë luftën kundër saj nuk e pushoi asnjëherë. Duke përcaktuar me saktësi e në mënyrë shkencore rolin reaksionar, antishkencor të fesë, Marksi ka shkruar: «Feja është psherëtimi e krijesës së shtypur, zemra e një bote pa zemër, ashtu sikurse ajo është shpirti i një sistemi pa shpirt. Feja është opiumi i popullit»¹⁾.

1) K. Marks — F. Engels. «Mbi fenë» Tiranë, 1970, f. 45.

Këtë shprehje të Marksit, V.I. Lenini e ka konsideruar si gurin themeltar të qëndrimit marksist ndaj çështjes së fesë.

Shoku Enver Hoxha duke treguar karakterin antishkencor dhe reaksionar të fesë, thekson: «Luf-tën tonë kundër fesë në duhet ta drejtojmë si kundër vetë dogmave fetare, pikëpamjeve filozofike, idealiste e mistike të saj, ashtu edhe kundër disiplinave fetare, që kanë hyrë deri në zakonet e përditshme të atyre që besojnë, bile edhe të atyre që nuk besojnë, por që ndonjëherë i zbatojnë pa i ditur...»¹).

Sikurse përmendëm, sipas vijës së Platonit, materia përceptohej si e privuar nga jeta. Ajo shërben, sipas tij, si një material inert nga i cili shpirti, ndërgjegjja, diçka mbinatyrore, ndërton qeniet e gjalla dhe i drejton ato nga jeta. Kështu, këtu mohohet mundësia e njohjes së jetës me metoda objektive dhe del në pah bërthama e rrymës idealiste mbi studimin e jetës.

Në kundërshtim me këtë, sipas pikëpamjeve materialiste të vijës së Demokritit, jeta, si dhe gjithë bota tjetër materiale, nga natyra e saj, është plotësisht e njohshme me anën e studimit objektiv të natyrës. Por, siç dihet, gjatë rendit feudal feja mori një pushtet të pakufizuar. Gjatë kësaj periudhe të errët të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, çdo shpjegim i natyrës duhej të bëhej në bazë të dogmave dhe librave fetare.

Dihet se edhe gjatë kësaj periudhe shoqëria njerëzore nxori njerëz të vendosur dhe të guxim-

1) PPSH. Dokumente kryesore, vëll. V, f. 240. Tiranë 1974.